

E DREJTA PËR INFORMIM

Pyetësor lidhur me të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” është autoriteti përgjegjës për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtës për ripërdorimin e dokumenteve, si dhe për shqyrtimin e ankesave nga qytetarët apo grupet e interes në rastet e mosrespektimit të këtij akti nga organet/institucionet e sektorit publik.

Në përmbushje të objektit të këtij ligji, Zyra e Komisionerit monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe procedurave që normojnë ushtrimin e të drejtës së ripërdorimit të të dhënave të hapura për qëllime fitimi ose jo të dokumenteve që mbahen nga organet e sektorit publik ose sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë.



Me qëllim ndërgjegjësimin e të gjitha organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, por edhe të mbledhjes së të dhënave dhe krijimit të statistikave, Zyra e Komisionerit ka hartuar një pyetësor që e konsultoni në lidhjen: [pyetësori për të dhënat e hapura](#).

Ky pyetësor u është shpërndarë subjekteve/organeve të sektorit/sipërmarrjeve publike, nëpërmjet të cilit ata kuptojnë detyrimet që duhen përmbushur në zbatim të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, në kuadër të rritjes së transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e funksioneve publike. Ky akt i rëndësishëm i legjislacionit kombëtar është përafëruar me Direktivën 2019/1024 me të njëjtin emërtim të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian.

Zyra e Komisionerit është në fazën e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe do t'i bëjë ato publike së shpejti.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë muajit gusht 2025 ka dhënë një vendim në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Sipas [vendimit nr. 26, datë 12.08.2025](#), Komisioneri ka pranuar ankesën ndaj Bashkisë Tiranë (në vijim “autoriteti publik” dhe/ose “AP”) me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”. Ankuesja, në cilësinë e kërkueses, nëpërmjet kërkesës për informacion datë 11.06.2025, depozituar në adresën elektronike edrejtaperinformim@tirana.al ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me: (a) dosjen e plotë tekniko-ligjore (përfshirë edhe nënshkrimet e banorëve që kanë dakordësuar) dhe genplanet e depozituara nga Brianza Dent sh.p.k; (b) çdo raport, vlerësim apo opinion ekspertësh mbi projektin (verifikime teknike); (c) vendimin e komisionit për pranimin e deklaratës.

Në mungesë të një përgjigje nga autoriteti publik, ankuesja, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” kontaktoi me koordinatoren për të drejtën e informimit pranë AP, duke kërkuar që të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Në vijim, AP ka kthyer përgjigje duke cituar se: “...Në vijim të kërkesës suaj ardhur pranë Bashkisë Tiranë ju bëjmë me dije se ka përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, të cilën e gjeni bashkëlidhur. Gjithashtu ju bëjmë me dije se kthim përgjigja edhe praktika shoqëruese ju është dërguar me shërbim postar...” Pas kësaj përgjigje, ankuesja ka vijuar me procedurën duke saktësuar se: “...Më 3 korrik 2025 mora përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila konfirmon “pranim të deklaratës paraprahe” të subjekti Brianza Dent sh.p.k. për kryerje punimesh (ashensorë, punime fasadash etj.), por nuk përfshin planarët, detajet teknike, as protokollin e banorëve pa kundërshti. Më datë 10 korrik 2025 i kam kërkuar përsëri koordinatoren për të drejtën e informimit pranë Bashkisë Tiranë plotësimin e dosjes me dokumentet e mëposhtme: planimetrinë, seksionet dhe detajet e projektit të instalimit të ashensorëve; deklaratën paraprahe të punimeve dhe protokollin e pranimit të saj; dakordesia e banorëve për mungesë kundërshtish...”

Pas vijimit të ankimit, Zyra e Komisionerit, i kërkoj sërish AP të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion. AP, nëpërmjet përgjigjes së mbërritur me email, deklaroi se: “...Sqarojmë se dokumentacionin e plotë ja kemi vendosur në dispozicion organit kompetent të inspektimit. ... bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën e pranimit të deklaratës paraprahe të punimeve si dhe projektin arkitektonik dhe konstruktiv të depozituar në aplikim dhe të pranuar me deklaratën paraprahe. Sqarojmë se deklaratën noteriale të dakordësisë së bashkëpronarëve banorë (e cila i është vendosur në dispozicion organeve të inspektimit) nuk mund ta vendosim në dispozicion të kërkueses, pasi referuar ligjit mbrojtjen e të dhënave personale, këto deklarata përmbajnë të dhëna personale, të cilat nuk mund të vihen në dispozicion”.

Ankuesja, sërish ka kërkuar vijimin e procedurës duke theksuar se: “...Projekt-planitet janë të plotë, por deklarata noteriale e bashkëpronarëve nuk u bë e disponueshme. Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale nuk mund të përdoret si arsye për refuzim. Unë nuk kërkoj asnjë të dhënë sensitive, por vetëm konfirmimin se firmëtarët janë banorë të këtij pallati, një fakt publik dhe i parashikuar nga aktet nënligjore për kuorumin e dakordësisë. Deri tani, Bashkia ka vepruar jashtë kuadrit të saj kompetencial, duke negociuar dhe dhënë leje paraprahe për ndërtimin e një ashensori nga një subjekt privat/tregtar në hapësirën publike të oborrit para pallatit... Duke dhënë këtë leje pa përmbushur kuorumin e dakordësisë së banorëve, siç parashikojnë vetë rregulloret e Bashkisë, institucioni ka tejkaluar kompetencat e tij dhe ka cenuar interesin publik. ... Ju lutem të kërkonin nga Bashkia Tiranë: Disponimin e deklaratës noteriale (ose një version anonim, me të dhënat personale të të redaktuara, ose mundësi konsultimi fizik në ambientet e tyre). Konfirmimin nëse kuorumi i banorëve është përmbushur sipas aktet nënligjore...”


Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga AP nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se, mosdhënia e informacionit të kërkuar bazohet në ligjin nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Komisioneri thekson se ky refuzim nuk gjen mbështetje në ligjin e sipërpërmendur, pasi informacioni i kërkuar duhet të trajtohet në përputhje me dispozitat e LDI,

si dhe është i rregulluar posaçërisht nga ligji nr. 10112/2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”. Njëkohësisht, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike.

Për sa më sipër, bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, Komisioneri vendosi: (1) pranimin e ankesës kundër autoritetit publik Bashkia Tiranë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”; (2) urdhërimin e AP për vënien në dispozicion të dokumentacionit në formatin e zotëruar, sipas kërkesës fillestare të sipërcituar, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE**